



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Tiranë, më 14 . 01 .2024

KËRKESË

KËRKUES: 30 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësuar me autorizimin e datës 05.12.2023 nga kryetari i Grupit Parlamentar të PD-së, **Z. Gazment Bardhi**.

OBJEKTI: Kërkesë për opinion këshillimor nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.

BAZA LIGJORE: Nenet 1 dhe 10, të Protokollit nr. 16, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
Neni 44/b, pika 1, i Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”;
Neni 35, pikat 1 dhe 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese;

**GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

E Nderuar Znj. Kryetare,
Të Nderuar Gjyqtarë,

Me kërkesën Nr. 2 (NJ) Regj. Them., datë 06.12.2023, 30 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se një e pesta e deputetëve), kanë kërkuar:

- (i) Shfuqizimin e Protokollit ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Për Forcimin e Bashkëpunimit në Fushën e Migracionit”.
- (ii) Pezullimin e procedurave për ratifikimin e Protokollit ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Për Forcimin e Bashkëpunimit në Fushën e Migracionit”.

Në përmbajtje të kërkesës, kërkesit kanë arsyetuar se Protokollit shkel disa prej të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht nenin 1 (detyrimi për të respektuar të drejtat dhe liritë), nenin 3 (ndalimi i torturës), nenin 5 (e drejta për liri dhe siguri), nenin 6 (e drejta për proces të rregullt ligjor), nenin 9 (liria e ushtrimit të

fesë dhe kryerjes së riteve), nenin 11 (liria e tubimeve dhe organizimit), nenin 13 (e drejta për zgjidhje efektive), nenin 14 (ndalimi i diskriminimit), nenin 2, të Protokollit shtesë (e drejta për arsim), nenin 2, të Protokollit 4 (liria e lëvizjes), dhe nenin 4, të Protokollit 4 (ndalimi i dëbimit). Po ashtu, në përmbajtje të kërkesës janë cituar edhe dy vendime të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht Hirsi Jama dhe të tjerë kundër Italisë, datë 23.02.2012, dhe J.A. dhe të tjerë kundër Italisë, datë 30.03.2023, të cilat kanë trajtuar pikërisht respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Konventa për refugjatët.

Lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të sanksionuara në Konventë nga Protokollin ndërmjet qeverive shqiptare dhe italiane, ka pasur reagime edhe nga organizata vendase dhe ndërkombëtare (shih paragrafët 22 – 26 të kërkesës), ku mund të sjellim në vëmendje qëndrimin e Komisioneres së Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut, Znj. Dunja Mijatovic, e cila është shprehur se: *“Memorandumi i Mirëkuptimit (MoU) ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë për zbarkimin dhe përpunimin e kërkesave për azil, i përfunduar javën e kaluar, ngre disa shqetësime për të drejtat e njeriut...”*. Më tej, Komisionerja shprehet se: *“Memorandumi i Mirëkuptimit ngre një sërë pyetjesh të rëndësishme që do të kishte zbatimi i tij për të drejtat e njeriut të refugjatëve, azilkërkuarve dhe migrantëve”*. Theksojmë se Zyra e Komisioneres është një strukturë që funksionon në kuadër të Këshillit të Europës, njësoj si Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e krijuar nëpërmjet një rezolute të Këshillit të Ministrave të datës 7 Maj 1999.

Shqipëria, si shtet anëtar i Këshillit të Europës dhe ratifikues i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore nëpërmjet Ligjit nr. 8137, datë 31.07.1996, ka detyrimin të sigurojë çdokujt brenda territorit të saj të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Titullin I të Konventës (shih nenin 1 të Konventës). Po ashtu, në sistemin e të drejtës së brendshme shqiptare, Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, i është dhënë një status i veçantë duke e barazuar me vetë Kushtetutën (shih vendimin nr. 6, datë 31.03.2006 të Gjykatës Kushtetuese). Konkretisht, në nenin 17, pika 2, të Kushtetutës përcaktohet se kufizimet e lirive dhe të drejtave nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Duke pasur në konsideratë, se të drejtat dhe liritë individuale të renditura në Kushtetutë dhe në Konventë janë analoge dhe përplotësuese, çdo shkelje e të drejtave të parashikuara në Konventë, konsiderohet njëkohësisht edhe si shkelje e Kushtetutës. Për rrjedhojë, korrigjimi i shkeljeve të Konventës do të thotë njëkohësisht edhe korrigjimi i shkeljeve të Kushtetutës (shih vendimin njësoj nr. 113, datë 22.07.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

Në këtë kuptim, është shumë e rëndësishme që gjatë shqyrtimit të kushtetutshmërisë së Protokollit, Gjykata të analizojë dhe konkludojë mbi shkeljet e pretenduara të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat njëkohësisht përbëjnë edhe shkelje të Kushtetutës. Kjo edhe për një arsye tjetër shumë të rëndësishme që ka të bëjë me faktin se në eventualitetin e ratifikimit të këtij Protokollit, ndaj Shqipërisë mund të paraqiten ankime sa i përket përmbushjes së detyrimit të saj të sanksionuar në nenin 1, të Konventës, për sigurimin e çdokujt në territorin e saj të të drejtave dhe

lirive themelore. Lidhur me këtë çështje, dëshirojmë të sjellim në vëmendje vendimin Hirsi Jama dhe të tjerë kundër Italisë, datë 23.02.2012, në të cilin GJEDNJ është shprehur se një shtet anëtar nuk mund t'i shmanget përgjegjësive dhe detyrimeve të saj në kuadër të Konventës dhe Protokolleve të saj, duke përdorur detyrimet që rrjedhin nga një marrëveshje dypalëshe (shih paragrafin 129). Prandaj, dhënia përgjigje shteruese të gjitha pretendimeve që lidhen me shkelje të mundshme të lirive dhe të drejtave të sanksionuara nga Konventa dhe Protokollet e saj, do të mbrojë pozitën e shtetit shqiptar me ankimet eventuale që mund të paraqiten në Gjykatë dhe pasojat e tyre.

Për shkak të natyrës shumë specifike të kësaj marrëveshjeve, mungesës së precedentëve të mëparshëm nga ana e Gjykatës Kushtetuese, jurisprudencës së kufizuar të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në këtë drejtim, si dhe duke sjellë në vëmendje nenin 32, pika 1, të Konventës, i cili përcakton se interpretimi dhe zbatimi i Konventës dhe Protokolleve të saj është në juridiksionin e Gjykatës, vlerësojmë se në rastin konkret analizën shteruese të Protokollit Shqipëri – Itali me Konventë dhe Protokollet e saj, duhet ta kryejë vetë Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, nëpërmjet mjeteve të parashikuara në Protokollin nr. 16, të Konventës, por edhe në dispozitat e Ligjit nr. 8577/2000 dhe Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Konkretisht, neni 1, i Protokollit nr. 16, të Konventës, parashikon se Gjykata dhe tribunale më të larta të një Pale të Lartë Kontraktuese mund t'i kërkojnë Gjykatës të japë opinione rekomanduese mbi çështje parimore të lidhura me interpretimin dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë ose protokollet e saj. Opinioni rekomandues mund të kërkohet vetëm në kontekstin e një çështje të mbetur pezull para saj. Në koherencë me Protokollin, në nenin 44/b, pika 1, të Ligjit nr. 8577/2000, është parashikuar se Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të çështjes, vendos të kërkojë një opinion këshillimor nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, lidhur me zbatimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe protokolleve shtesë të saj. Ndërsa, në nenin 35, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore, parashikohet se Gjykata vendos, *ex officio* ose me kërkesë të palëve në gjykim, të kërkojë një opinion këshillimor nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, për zbatimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Konventa dhe Protokollet e saj.

Prandaj, duke pasur parasysh pretendimet e kërkuarve lidhur me shkeljen e lirive dhe të drejtave të garantuara nga Konventa, reagimet e organizatave vendase dhe ndërkombëtare, veçanërisht qëndrimin e Komisioneres së Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut, natyrën shumë specifike të kësaj marrëveshjeje, impaktin e saj të gjërë kombëtar dhe ndërkombëtar, mungesën e precedentëve të mëparshëm nga Gjykata Kushtetuese, jurisprudencën e kufizuar të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në këtë drejtim, si dhe juridiksionin eskuziv të kësaj të fundit për të bërë interpretimin e Konventës dhe Protokolleve të saj, si dhe interesin e shtetit shqiptar, i cili, në eventualitetin e ratifikimit, mund të përballet me ankime në GJEDNJ për shkelje të

Konventës, në mbështetje të nenit 1, të Protokollit nr. 16, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenit 44/b, të Ligjit nr. 8577/2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatës Kushtetuese”, dhe nenit 35, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, *përfundimisht*,

KËRKOJMË:

- Marrjen e një opinion këshillimor nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut për zbatimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Protokollin ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Për Forcimin e Bashkëpunimit në Fushën e Migracionit”.

KRYETARI

Gazment BARDHI

